



AKT THEMELIMI (KONTRATE)

PER KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE

KUFIZUAR (SH.P.K.)

"Fastech" Sh.p.k.

Kontraktuesi Andis Papa ne perputhje me ligjet: Nr.7512, date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, e iniciatives se lire e veprimtarive private te pavarura dhe te privatizimit"; Nr. 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite Tregtare " Nr. 7754, date 12.11.1993 "Per investimet e huaja" si edhe me dispozitat e tjera ne fuqi te legjislacionit shqiptar, ra dakord si me poshte :

Neni 1

Te themeloje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar per te zhvilluar veprimtari ekonomike industriale e tregtare ne perputhje me objektin se veprimtarise se saj te emertuar :

" Festech" Sh.p.k.

Qendra zyrtare e saj do te jete ne Rr. "Brigada e 8, Nr. 6 Tirane, Shqiperi,

Neni 2

Shoqeria eshte person juridik i se drejtes shqiptare, qe zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, me kete Akt Themelimi (Kontrate) dhe me Statutin qe i bashkelidhet ketij akti dhe qe eshte pjese perberese e tij.

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj. Ajo nuk pergjigjet ne asnjë rast per detyrimet qe mund te marrin persiper ortaket e saj dhe po keshtu, ortaket nuk pergjigjen personalisht per detyrimet e shoqerise e as nuk perballojne humbjet e saj pertej kontributit te dhene prej tyre per krijimin e shoqerise.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e shtetit shqiptar e anasjelltas.

Neni 3

Objekti i veprimtarise



Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

- Marrja pjese dhe dhenia e assitencave e trajnimeve ne fushen e informatikes.
- Shitia e blerja e pajisjeve te tilla si kompjutera, projektor, kamera digitale, skaner, printer, fotokopje, fakse etj.
- Krijimi i linjave per montimin e kompjuterave dhe te studjoive digitale
- Sigurimi i pjeseve te kembimit per te gjitha llojet e pajisjeve te tilla dhe ralizimi i sherbimit te mirembajtjes te riparimit.
- Realizimi i projektimit dhe istalimit te rrjeteve kompjuterike.
- Perpunimi i te dhenave ne kompjuter e pajisje te tjera me synim realizimin e sherbimeve te tilla si perqatitje faqe interneti, perqatitje reklamash, posterash, ftesash, kartvizitash e deri ne shtypje e lidhje libri.
- Kryerja e veprimtarive te tjera tregtare si shitja e blerja me shumice e pakice te artikujve te kancelerise, pajisje elektrike e elektronike shtepijake etj.
- Realizimi i Import-eksportit te te gjithe artikujve te permendur me siper.

Neni 4

Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqerise eshte caktuar mbi 10 vjet, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykatene e Shkalles se pare te Tiranes , si dhe ne organet kompetente tatimore. Kohezgjatja mund te zgjatet ose te shkurtohet me vendim te asamblese se ortakeve.

Kjo marreveshje dhe aktet qe i bashkelidhen sa kohe qe shoqeria do te kete nje ortak te vetem, perfaqesojne vullnetin e pote te tij dhe mund ta ndryshojne vetem me vendim tjeter te tij me shkrim. Kur ne kete shoqeri vendoset qe te marrim pjese edhe ortake te tjere, atehere pjese te kesaj marreveshje e te statutit qe krijohet, ndryshojne me marveshje me shkrim midis paleve



Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar eshte 100 000 (njeqindemije) leke.

Ortaku i vetem Andis Papa kontribuon duke patur 100% te kapitalit te barabarte me 100 000 leke.

Ky kontribut dhe ndryshimet qe mund te pasojne ate ne te ardhmen regjistrohen dhe kontabilizohen ne librin e llogarive e ne regjistrat e posaqme te Shoqerise. Shtimi i kapitalit nuk eshte i kufizuar.

Likuditetet dhe transaksionet financiare do te depozitohen e mbeshteten ne Banken e Tiranes, ku do te hapet llogaria rrjedhese sipas mundesise se Shoqerise ose ne banka te tjera shqiptare ose te huaja.

Neni 6

Caktimi i organeve drejtuese te Shoqerise

Asambleja e ortakeve cakton organet drejtuese te Shoqerise te perbera nga ortaket ose nga persona fizike jo ortake.

Neni 7

Ndarja e fitimeve

Fitimi neto i Shoqerise, pasi te jene zbritur shumat qe u perkasin detyrimeve ligjore dhe fondit rezerve, ndahet ndermjet ortakeve perpjeksimisht me kontributet e tyre ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Fitimet dhe shperblimet e tjera qe u takojne ortakeve te huaj mund te transferohen lirisht jashte shtetit.

Neni 8

Sekreti

Ortaket detyrohen resiproksht te mbajne sekret informacionin dhe pervojen e grumbulluar gjate veprimtarise se Shoqerise, si edhe te dhenat e ndryshme qe i

perkasin asaj, duke marre te gjitha masat e nevojshme per te shmangur perhapjen e tyre, qofte edhe te pjeseshme.

Ortaket pergjigjen per demet qe mund te rrjedhin nga mosrespektimi i ketyre detyrimeve.



Neni 9

Organet e Shoqerise

Organet e Shoqerise jane :

- a) Asambleja e ortakeve
- b) Administratori i vetem
- c) Eksperti kontabel i autorizuar

Modalitetet lidhur me perberjen dhe funksionet e organeve te mesiperme tregohen hollesisht ne Statutin e Shoqerise bashkelidhur, qe eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Brenda tri javeve nga regjistrimi i Shoqerise duhet te mblidhet ne seline e saj **Asambleja e ortakeve** (ne qoftese ka me shume se nje ortak) per te percaktuar personat ne funksionet e tyre.

Administrator i vetem dhe drejtor i pergjithshem e shoqerise eshte Andis Papa.

Neni 10

Detyrat e ortakeve themelues per fillimin e veprimtarise se Shoqerise.

Ortaku themelues detyrohet te punoje per perqatitjen dhe fillimin e veprimtarise se Shoqerise me qellim qe te realizohen objektivat e saj si edhe per nje administrim te mire te saj gjate gjithe periudhes se ekzistences se saj.

Neni 11

Kjo kontrate do te konsiderohet e rene nga fuqia dhe Shoqeria do te prishet pa asnje detyrim per palet, ne rast se, se paku brenda tre muajve nga nxjerrja e lejeve e licensave te nevojshme, nuk do te sigurohenn fondet e duhura per financimin e puneve ose ne qofte se keto te fundit nuk do te kene filluar.

Neni 12

Mosmarreveshjet



Mosmarreveshjet eventuale qe mund te lindin lidhur me interpretimin dhe/ose zbatimin e kesaj kontrate ose ne marredheniet ndermjet ortakeve(ne qoftese se do te kete, midis ketyre dhe Shqiperise apo organeve te saj, do te zgjidhen ne menyre miquesore. Kur kjo nuk do te arrihet, mosmarreveshja do te gjykohet nga Gjykata e Rrethit te Tiranes sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 13

Dispozita te hollesishme per Shoqerine permban Statuti i saj, qe eshte pjesa perberese e ketij Akti.

Neni 14

Ky Akt Themelimi (Kontrate) eshte hartuar ne gjuhen shqipe, ne pese ekzemplare, duke pasur te tekstet fuqi te barabarte dhe hyn ne fuqi menjehere me nenshkrimin e tij.

Hartuar ne Tirane, me 23.03.1998

ORTAKU THEMELUES

Andis Papa

Andis Papa

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Andis Papa".